



Viti i VII-të i Botimit, Nr.1,
Qershorë 2016

KORRIGJIMI ORTOPEDIK I MALOKLUZIONIT TË KLASËS SË III-TË ME ANË TË ZGJERUESIT TË SHPEJTË DHE AVANCIMI I MAKSILËS ME ANË TË MASKËS FACIALE NË NJË PACIENT NË PËRFUNDIM TË RRIJTJES

Ela Dodaj*, Fation Subashi**

*Departamenti i Ortodoncisë, Fakulteti i Shkencave Mjekësore, Albanian University

**Klinikë private

Adresë kontakti: eladodaj89@gmail.com

Përmbledhje

Hyrja: Paraqitje rasti të një pacienti mashkull 13 vjeç me malokluzion dhe profil skeletik të klasës së III-të dhe me praninë e një kafshimi të kryqëzuar anterior dhe devijim skeletik. Malokluzioni i klasës së III-të u korrigjua me anë të një zgjeruesi të shpejtë me rrafshe posteriore (McNamara) dhe me maskën e Delaire për avancimin ortopedik të maksilës përpara.

Qëllimi: Arritja e avancimit përpara dhe poshtë të maksilës dhe zgjerimi i saj në plan transversal që do të krijonte një okluzion të ekuilibruar, me qëllim që pacienti të bënte një rritje normale dhe të kontrollouar.

Metoda: Ekzaminimi ekstraoral dhe intraoral, analiza cefalometrike në grafinë laterale për të marrë të dhëna të sakta të raporteve kraniale me maksilën dhe mandibulën. Përdorimi i zgjeruesit të shpejtë dhe i maskës faciale.

Rezultatet: Maksila u rrit poshtë dhe përpara, pra klasa skeletike u ndryshua nga klasa e III-të në klasë të I-rë. Maksila pësoi zgjerim në plan transversal. Zgjidhja e kafshimit të kryqëzuar u arrit me një overbitë normal dhe overjet të rritur. Profili është përmirësuar duke nxjerrë në dukje buzën e sipërme, e cila më parë ishte shumë retruze. Profili i tij u shndërrua nga një profil i drejtë në profil harmonik.

Përfundimet: Pacienti pati një përmirësim të dukshëm në raportet skeletike, okluzion dhe profilin e fytyrës. Mundësitë e një recidive janë të vogla për arsye se pacienti është shumë afër pikut të rritjes, ai do të nisë fazën e dytë të trajtimit në momentin që do të kalojë në denticion të përhershëm.

Fjalë çelës: malokluzion i klasës së III-të, zgjerues i shpejtë maksilar, maskë faciale.

ORTHOPEDIC CORRECTION OF THIRD MALOCCLUSION WITH RAPID MAXILLARY EXPANDER AND THE ADVANCE FORWARD OF MAXILLA WITH FACE MASK IN A PATIENT AT THE END OF GROWTH

Abstract

Introduction: Case presentation of a 13 year old male patient with malocclusion and class III skeletal profile and with the presence of an anterior cross bites and skeletal deviation.

Korrigjimi ortopedik i malokluzionit të klasës së III-të me anë të zgjeruesit të shpejtë dhe avancimi i maksilës me anë të maskës faciale në një pacient në përfundim të rritjes

Malocclusion of class III was corrected by a quick maxillary expander with posterior planes (McNamara) and Delaire mask to realize the orthopaedic advancing of maxilla forward.

Purpose: Achieving promotion forward and down of maxilla and expansion in transversal plane which will create a balanced occlusion so that the patient will do a normal and controlled growth.

Method: Intraoral and extra oral examination, cephalometric analysis to take information on cranial reports of maxilla and mandible. The rapid maxillary expander and a face mask were used.

Results: Maxilla increased forward and down, the class skeletal is changed from third to first class. Maxilla is expanded in transversal plane. The anterior crossbite is adjusted with a normal overbite and overjet. The profile is improved so the upper lip is more evident, which was earlier retruse. His profile has changed from straight one to a harmonic.

Conclusion: The patient made improvements into skeletal reports, occlusion and profile of face. The possibilities of a relapse are minor because he is near of the peak growth, he will start the second phase of treatment in permanent dentition.

Keywords: malocclusion of third class, rapid maxillary expander, face mask.

Hyrja

Qëllimi i këtij rasti ishte të zgjidhte malokluzionin e klasës së III-të me përdorimin e zgjeruesit të shpejtë të maksilës dhe të maskës faciale. Shumë nga malokluzionet e klasës së III-të janë rezultat i prognatizmit mandibular, por një përqindje e lartë e tyre janë rezultat i një maksile të pazhvilluar. Avancimi përpara i maksilës me anë të maskës faciale është një protokoll trajtimi rutinë për sa i përket malokluzionit të klasës së III-të.

Zgjerimi i maksilës është i nevojshëm në trajtim për të rritur gjerësinë transversale të maksilës dhe për të rritur efikasitetin e avancimit përpara të saj, duke mundësuar aktivizimin e të gjithë sistemit të suturave. Forcat ortopedike veprojnë në nivel gutural (sutura palatine mediane dhe cirkumaksilare) dhe të ligamentit periodontal të dhëmbëve.

Aplikimi i një force rreth 500-1000 gramë rekomandohet për avancimin përpara të maksilës.

Materiale dhe metoda

Një pacient mashkull 13 vjeç u paraqit në klinikë, prindërit ishin të interesuar për zgjidhjen e problemit me kafshim të kryqëzuar anterior dhe për ndryshimin e profilin, me qëllim që të paraqitej i drejtë në konkav.

Diagnoza

Ekstraorale: Pacienti paraqitet me një profil skeletik të III-të, trup mandibular normal dhe një maksilë retruze, me deficite antero-posteriorë dhe vertikale. Profili shumë i drejtë me tendencë në konkave dhe buzë kompetente (fig. 1). Paraqitet me një kënd frontonazal normal, kënd të hapur nazolabial dhe kënd labiamental të hapur.




Fig.1 Fotot ekstraorale ne profil para trajtimit

Pacienti karakterizohet nga një normodivergjencë e fytyrës.
Devijim i linjës mediane djathtas (fig. 2).




Fig.2 Fotot ekstraorale frontale para trajtimit

Korrigjimi ortopedik i malokluzionit të klasës së III-të me anë të zgjeruesit të shpejtë dhe avancimi i maksilës me anë të maskës faciale në një pacient në përfundim të rritjes

Intraorale: Pacienti paraqitet me një raport molar dhe kanin të III-të, kafshim i kryqëzuar anterior dhe unilateral posterior në anën e djathtë (fig. 3).



Fig.3 Foto intraorale laterale majtas dhe djathtas para trajtimit

Prezencë denticioni permanent (mungon në harkadë 23), (fig. 4).




Fig.4 Grafia panoramike para trajtimit

Studimi në modele tregon për një overbite -3 mm dhe një overjet -2.7 mm. Devijim i linjës mediane dentare poshtë në të djathtë (fig .5).




Fig.5 Fotot intraorale frontale dhe overjet para trajtimit

Plani i trajtimit

Vendosja e një RME të tipit McNamara, u instruktuan prindërit për aktivizimin 1 herë në ditë për 15 ditë, pastaj u ndalua aktivizimi pas një rezultati pozitiv (fig. 6). Tek zgjeruesi u vendosën 2 krahë vestibularë që shërbejnë për të vendosur elastikët ekstraoralë për tërheqjen me anë të maskës faciale, të cilët pacienti i ndërron çdo javë. Atij ju dhanë elastikë $\frac{1}{4}$ 16 oz për 4 muaj.




Fig.6 Foto para dhe pas zgjerimit me RME

Korrigjimi ortopedik i malokluzionit të klasës së iii-të me anë të zgjeruesit të shpejtë dhe avancimi i maksilës me anë të maskës faciale në një pacient në përfundim të rritjes

Maska faciale u zgjodh e tipit Petit me një krah anterior në mënyrë që t'i krijojë komoditet pacientit gjatë gjumit.

Pacienti u udhëzua ta mbante maskën sa më shumë të ishte e mundur, të paktën për 16 orë në ditë për 4 muaj deri në arritjen e rezultatit të pritur. Më pas orët e mbajtjes së maskës faciale reduktohen (fig. 7).




Fig.7 Foto e pacientit me maske faciale

Pacienti pas heqjes së aparateve do të përdorë retainer të lëvizshëm deri në përfundim të rritjes për të ruajtur rezultatin.

Rezultatet e arritura

Maksila u zgjerua në plan transversal duke eliminuar kafshimin e kryqëzuar posterior, u rrit përposh dhe përpara duke kaluar në një overjet dhe overbite pozitiv (fig. 8).



Fig.8 Para trajtimit

4 muaj pas trajtimit

Këndi ANB u ndryshua nga -2.4 në 2.9, d.m.th. klasa skeletike kaloi nga klasë e III-të në klasë të I-rë. Këndi SNA u rrit me 5.2. Rritja e mandibulës nuk pati ndonjë diferencë në këndin SNB pas terapisë (fig. 9). Këndi nazolabial u zvogëlua.

	T1	T2
SNA	79.4	84.6
SNB	81.7	81.7
ANB	-2.3	2.9
Go-Gn S-N	34	34

Fig.9 Vlerat cefalometrike para dhe pas trajtimit



Profili i fytyrës është përmirësuar duke sjellë më në pah tashmë buzën e sipërme, e cila ishte e papërfillshme. Profili u shndërrua nga i drejtë në harmonik (fig. 10). Pacienti vazhdon ende trajtimin. Gjithmonë ka një recidivë në malokluzionin e klasës së III-të, kështu që pacienti do të ndiqet gjatë viteve me mbajtjen e një aparati të lëvizshëm deri sa të përfundojë rritjen. Ai do të vazhdojë me fazën e dytë të trajtimit në momentin që do të kalojë në denticionin e përhershëm.



Fig.10 Para trajtimit

4 muaj pas trajtimit RPE+Petit

Korrigjimi ortopedik i malokluzionit të klasës së iii-të me anë të zgjeruesit të shpejtë dhe avancimi i maksilës me anë të maskës faciale në një pacient në përfundim të rritjës



Referencat

1. G. A. Vaughn, B. Mason, H. Moon, and P. K. Turley, "The effects of maxillary protraction therapy with or without rapid palatal expansion: a prospective, randomized clinical trial," *American Journal of Orthodontics & Dentofacial Orthopedics*, vol. 128, no. 3, pp. 299–309, 2005.
2. P. E. Nartallo-Turley and P. K. Turley, "Cephalometric effects of combined palatal expansion and facemask therapy on class III malocclusion," *Angle Orthodontist*, vol. 68, no. 3, pp. 217–224, 1998.
3. D. Merwin, P. Ngan, U. Hagg, C. Yiu, and S. H. Wei, "Timing for effective application of anteriorly directed orthopedic force to the maxilla," *American Journal of Orthodontics & Dentofacial Orthopedics*, vol. 112, no. 3, pp. 292–299, 1997.
4. J. A. McNamara Jr., "An orthopedic approach to the treatment of Class III malocclusion in young patients," *Journal of Clinical Orthodontics*, vol. 21, no. 9, pp. 598–608, 1987.
5. H. Ishii, S. Morita, Y. Takeuchi, and S. Nakamura, "Treatment effect of combined maxillary protraction and chin cap appliance in severe skeletal Class III cases," *American Journal of Orthodontics and Dentofacial Orthopedics*, vol. 92, no. 4, pp. 304–312, 1987.
6. K. Takada, S. Petdachai, and M. Sakuda, "Changes in dentofacial morphology in skeletal Class III children treated by a modified maxillary protraction headgear and a chin cup: a longitudinal cephalometric appraisal," *European Journal of Orthodontics*, vol. 15, no. 3, pp. 211–221, 1993.
7. P. Ngan, H. Urban, C. Yiu, D. Merwin, and S. Wei, "Soft tissue and dentoskeletal profile changes associated with maxillary expansion and protraction headgear treatment," *American Journal of Orthodontics & Dentofacial Orthopedics*, vol. 109, no. 1, pp. 38–49, 1996.
8. A. Kapust, P. Sinclair, and P. K. Turley, "Cephalometric effects of face mask/expansion therapy in Class III children: a comparison of three age groups," *American Journal of Orthodontics & Dentofacial Orthopedics*, vol. 113, no. 2, pp. 204–212, 1998.
9. S. Braun, "Biomechanical considerations in the management of the vertical dimension," *Seminars in Orthodontics*, vol. 8, no. 3, pp. 149–154, 2002.



SHKENCAT SHOQËRORE

SEKSIONI 2

